



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Data	04.08.15	Vendi	KAÇANIK
Tipi org.		Numri	
	03	5-24185	✓

Në bazë të nenit 8 pika 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr.03/L-212, Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Drejtoria Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale shpall këtë:

KONKURS

I. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE TITULLI I VENDIT TË PUNËS: 1. TEKNIK LABORANT I MJEKSISË Koeficienti 5.4

Numri i referencës së vendit të punës: Nr.74

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Kryen analizat rutinore laboratorike, hetamologjike dhe të urinë.
- Kryen analiza shtese sipas kërkesave të mjekëve
- Kryen analizat emergjente sipas udhëzimeve të mjekëve.
- Kujdeset dhe mirëmban aparaturën laboratorike.
- Kujdeset për mbarrëvajtjen e punës në laborator
- Kryen edhe punë tjera profesionale dhe kujdeset për pastërtinë e ambientit të punës
- Bënë planifikimin, kërkesave për materialin harxhues laboratorik
- I kryen të gjitha punët në laborator si sterilizimin, larjen e epruvetave etj.
- Bënë raportet mujore për harxhimet e materialit laboratorik
- Mbanë evide icën e pacienteve dhe bënë dhe bënë përpunimin e të dhënave të tyre
- Mbanë përgjegjësi për mangësi apo parregullsi të punës në laborator
- Zbaton urdhëresat e menaxherëve në çdo kohë.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

- Shkolla e Mesme-Teknik laborantë i mjekësisë
- Përvoja e punës e dëshirueshme

II. TITULLI I VENDIT TË PUNËS: DY MJEK TË MJEKËSISË FAMILJARE

Vendi i punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Koeficienti 7.2

Numri i referencës së vendit të punës: Nr.67

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Ofrim i shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe në teren
- Mjeku familjar jep këshilla dhe ofron ndihmë për të gjitha sëmundjet në përgjithësi duke u përkujdesur në vazhdimësi për mbrojtjen e shëndetit. Përkujdesja e mjekut familjar përfshinë këto lami:
- Jep këshilla mjekësor rreth mbrojtjes së shëndetit dhe njeh sëmundjet;
- Diagnostifikimi i sëmundjes dhe trajtimi i pacientit;
- Udhëzon dhe trajton në mjekimin parandalues të sëmundjes.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja, dhe atributet tjera që kërkohen:

- Diploma Universitare- (Fakulteti i Mjekësisë)
- Certifikata e licencimit dhe dëshmi tjera të aftësisë, të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit.

III. TITULLI I VENDIT TË PUNËS: 1. VOZITËS

Vendi i punës: Qendra Krvesore e Mjekësisë Familjare

Koeficienti 4

Numri i referencës së vendit të punës: Nr.114

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Të transporton me automjet personelin apo klientet (kur kërkohet nga ai)
- Të bënë inspektim operacional të makinës si p.sh.: rrotat, dritat, frenat, derivatet, vajin si dhe inspektim të jashtëm, të bënë mirëmbajtjen dhe riparime të thjeshta rutinore, të raporton problemet , të garazhon dhe pastron makinën.
- Në makinë vozitësi duhet të ofrojë një atmosferë të këndshme dhe të shoqërueshëm për pasagjerët dhe ti ndihmon ata në hyrje-dalje nga makina.
- Të mbanë radiolidhjen me qëllim të mbarëvajtjes së punës
- Të kompletin raportin mbi detyrat dhe aktivitetet ditore me informacionet siç janë: koha kur është operuar me makinë, numri i kilometrave të kaluara, numri i pasagjerëve dhe informata tjera të kërkuara nga mbikëqyrësi.

Shkollimi i kërkuar: - Shkolla e mesme
- Patentë shoferi- me kategori C,

Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Njohuri dhe shkathtësi nga lëmia e vozitjes
- Njohuri bazike për mirëmbajtjen e automjetit

IV. TITULLI I VENDIT TË PUNËS: 1. PASTRUES

Koeficienti 5

Numri i referencës së vendit të punës:03-5-24185

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Mirëmbajtjen e objektit në aspektin higjenik
- Ruajtja dhe mirëmbajtja e inventarit dhe mjeteve të punës gjatë pastrimit të tyre.
- Dhe ofrimi i ndihmës teknike zyrave duke i pastruar me material të nevojshme si letër aplikacione etj.
- Zbaton urdhëresat e menaxherit në çdo kohë.
- Të kujdeset për ndezjen dhe ndërprerjen e nxehtësisë.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

- Shkolla e Mesme ose fillore
- Përvoja e punës e dëshirueshme

Procedurat e konkurrimit: Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe ato ekzistues

Kohëzgjatja e emërimit : Në bazë të Ligjit të punës Nr.03/L-212,

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim të qytetarëve, kati përdhese, dhe në web-faqen komunale, brenda 15 ditë prej ditës së shpalljes së konkursit në shtyp.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, certifikatën shëndetësore, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë Drejtorinë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

